



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2021:166325
Datë: 14.12.2023
Numri i dokumentit: 05065478

PA1.nr.782/23

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata e Apelit e Kosovës - Departamenti i Përgjithshëm, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Skender Çoçaj, kryetar i kolegjit, Abdullah Ahmeti dhe Zyhdi Haziri anëtar, me praktikantin gjyqësor Arben Arifi si procesmbajtës, në lëndën penale kundër të akuzuarit M.S., nga fshati..., K. Rahovec, për shkak të veprës penale Asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë nga neni 321 par.1 të KPRK-së, duke vendosur sipas ankesës së Prokurorisë Themelore në Gjakovë si dhe ankesës së përfaqësuesit të palës së dëmtuar K.S., av.Agron Karatash, të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjakovë – Dega në Rahovec, me numër të lëndës 2021:166325 të datës 12.12.2022, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë 12.Dhjetor 2023 mori këtë:

A K T G J Y K I M

- I. REFUZHET si e pabazuar** ankesa e Prokurorisë Themelore në Gjakovë, ndërsa aktgjykimi i ankimuar i Gjykatës Themelore në Gjakovë – Dega në Rahovec, me numër të lëndës 2021:166325 të datës 12.12.2022, **VËRTETOHET.**
- II. HUDHET** si e palejuar ankesa e përfaqësuesit të palës së dëmtuar K.S., av.Agron Karatash, e ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjakovë – Dega në Rahovec, me numër të lëndës 2021:166325 të datës 12.12.2022 (neni 381 par.3 të KPPRK-së).

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e atakuar të Gjykatës Themelore në Gjakovë – Dega në Rahovec, me numër të lëndës 2021:166325 të datës 12.12.2022, i akuzuari M.S., konform nenit 364

paragrafi 1 nën par.1.3 të KPPRK-se, është liruar nga akuza për shkak të vepres penale Asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë nga neni 321 par.1 të KPRK-së.

Shpenzimet e procedurës penale bien në barrë të mjeteve buxhetore të gjykatës.

I dëmtuari K.S. për realizimin e kërkesës pasurore juridike është udhëzuar në kontest të rregullt civil.

Kundër këtij aktgjykimi, në afatin ligjor ankesa kanë ushtruar:

Prokuroria Themelore në Gjakovë për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe shkeljes së ligjit penal, me propozim që Gjykata e Apelit e Kosovës aktgjykimin e ankimuar të gjykatës së shkallës së parë ta anuloj dhe çështjen t’ia kthej gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe vendosje apo që të njëjtin ta ndryshoj dhe të akuzuarin ta shpall fajtor për veprën penale për të cilën është akuzuar t’i shqiptoj një dënim të parapare në Kodin Penal.

Përfaqësuesi i palës së dëmtuar K.S., av.Agron Karatash nga Prizreni, për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe shkeljes së ligjit penal, me propozim që Gjykata e Apelit e Kosovës aktgjykimin e ankimuar të gjykatës së shkallës së parë ta ndryshoj dhe të akuzuarin M.S. t’ia shpallë fajtor dhe t’i shqiptoj sanksion penal apo që të njëjtin aktgjykim ta anuloj dhe ta kthej në rigjykim dhe rivendosje.

Gjithashtu përgjigje në ankesë ka parashtruar mbrojtësi i të akuzuarit M.S., av.Prek Kolaj, i cili ka propozuar që ankesa e Prokurorisë Themelore në Gjakovë dhe ankesa e përfaqësuesit të palës së dëmtuar të refuzohen si të pabazuara.

Prokurori i Apelit të Kosovës, duke u shpjeguar përkitazi me ankesën e Prokurorisë Themelore në Gjakovë dhe ankesën e përfaqësuesit të palës së dëmtuar K.S., av.Agron Karatash, me shkresën e vet PPA.II.nr.817/23 të datës 30.06.2023 ka propozuar që Gjykata e Apelit e Kosovës ankesën e Prokurorisë Themelore në Gjakovë, ta aprovojë si të bazuar ndërsa ankesën e përfaqësuesit të palës së dëmtuar ta hudhë si palejuar.

Gjykata e Apelit caktoi seancën e kolegjit në pajtim me nenin 390 paragrafi 1 të KPPRK-së, në të cilën prezantoi vetëm përfaqësuesja me autorizim të palës së dëmtuar K.S., av.Bahrije Besimi nga Prizreni, ndërsa palët e tjera munguan edhe pse të njoftuar në mënyrë të rregullt, andaj seanca e kolegjit u mbajt në pajtim me nenin 390 par.4 të KPPRK-së. Përfaqësuesja e palës së dëmtuar av.Bahrije Besimi propozoi që ankesa e Prokurorisë Themelore në Gjakovë dhe ankesa e përfaqësuesit të palës së dëmtuar të aprovohen si të bazuara.

Gjykata e Apelit të Kosovës, konform nenit 394 par.1 të KPPK-së shqyrtoi shkresat e lëndës, vlerësoi aktgjykimin e ankimuar, pretendimet ankimore të Prokurorisë Themelore në Gjakovë dhe ankesën e përfaqësuesit të palës së dëmtuar dhe gjeti se:

- **Ankesa e Prokurorisë Themelore në Gjakovë nuk është e bazuar, ndërsa ankesa e përfaqësuesit të palës së dëmtuar hudhet si e palejuar.**

Sa i përket shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale Prokuroria Themelore në Gjakovë me ankesë pretendon se aktgjykimi i ankimuar i gjykatës se shkalles se pare eshte i përfshire me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par.1 nën par.1.12 të KPPRK-së, ngase ky aktgjykim nuk është përpiluar në pajtim me nenin 369 të KPPRK-së për faktin se nuk janë dhënë arsyet e mjaftueshme dhe të qarta mbi faktet vendimtare kur të akuzuarin e ka liruar nga akuza si dhe duke qenë se dispozitivi i aktgjykimit është në kundërshtim me brendinë e tij, me arsyetimin si dhe faktet vendimtare dhe me përmbajtjen e provave materiale të administruara si në shkresat e lendes, e të cilat shkelje aktgjykimin e bëjnë të paqëndrueshëm për çka të njëjtin duhet anuluar.

Gjykata e Apelit e Kosovës, vlerësoi pretendimet ankimore të Prokurorisë Themelore në Gjakovë lidhur me shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe konstatoi se të njëjtat nuk janë të bazuara ngase aktgjykimi i ankimuar i gjykatës se shkalles se pare eshte i qarte dhe i kuptueshëm dhe si i tille përmban arsye të mjaftueshme përkitazi me faktet relevante të kësaj çështje juridiko penale si dhe faktet nga të cilat varet edhe aplikimi i drejte i dispozitave të ligjit penal, ngase në rastin konkret nuk është arritur që të vërtetohet se i akuzuari M.S. të ketë kryer veprën penale Asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë nga neni 321 par.1 të KPRK-së , andaj edhe të njëjtin e ka liruar nga akuza, ngase në veprimet e të akuzuarit nuk plotësohen elementet e veprës penale për të cilat është akuzuar.

Sa i përket bazës ankimore vërtetimi i gabuar dhe jo i plotë i gjendjes faktike Prokuroria Themelore në Gjakovë, me ankesë pretendon se gjykata e shkallës së parë si pasoje e shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale gabimisht dhe në mënyre jo të plote e ka vërtetuar gjendjen faktike dhe se është i paqëndrueshëm konstatimi i gjykatës se shkalles se pare se me vlerësimin e provave materiale dhe personale kinse nuk është vërtetuar se i akuzuari t'a ketë kryer veprën penale të përshkruar si në dispozitivin e aktakuzës dhe se sipas Prokurorisë nga provat e administruara në gjykatën e shkalles se pare si deklarata e të akuzuarit të dhënë në polici me date 16.06.2021 i njëjti në tërësi ka pranuar veprimet inkriminuese e të cilën deklarate e ka dhënë në menyre vullnetare dhe pa shtrëngim dhe ka kërkuar falje, e se sikur kjo deklaratë dhe shkresat e tjera në lende të ish-in vlerësuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë i akuzuari është dashur që shpallet fajtor e jo gjykata të nxjerrë aktgjykim lirues me çka edhe në rastin konkret kur gjykata e shkalles se pare kur të akuzuarin e ka liruar nga akuza e ka shkelur edhe ligjin penal në favor të të akuzuarit.

Kolegji penal i Gjykatës së Apelit të Kosovës vlerësoi pretendimet ankimore të Prokurorisë Themelore në Gjakovë, lidhur me vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe gjeti se pretendimet e tilla nuk janë të bazuara. Sipas kësaj gjykate, gjykata e shkallës së parë drejtë ka konstatuar se nuk ka prova të mjaftueshme që i akuzuari të ketë kryer veprën penale për të cilën është akuzuar.

Nga provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor para gjykatës se shkalles se pare, si dëgjimi i dëshmitarve L.S., K.S., A.B., B.T., dëgjimin e të akuzuarit dhe të dëmtuarit gjykata e shkalles se pare nuk ka arritur që të vërtetojë se i akuzuari M.S. të ketë kryer veprën penale Asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë nga neni 321 par.1 të KPRK-së, ngase të gjithë këta dëshmitarë kanë deklaruar se i akuzuari në kohën për të cilën akuzohet se e ka kryer veprën penale nuk i njëjti nuk e ka punuar token pasi që ka punuar si kamarier në Q... në Xërxë, gjithashtu edhe i akuzuari ka deklaruar se nuk ia ka shkaktuar dëmin të dëmtuarit pasi që këtë tokë – arë e punon dhe e shfrytëzon axha i tij L.S. dhe se në kohën për të cilën pretendohet se i akuzuari ia ka shkaktuar dëmin ai ka qene duke punuar si kamarier në Q... në Xërxë. Andaj, gjykata e shkalles se pare bazuar në nenin 360 par.1 dhe par.2 të KPPRK-

së i cili parasheh qe gjykata e bazon aktgjykimin vetëm ne fakte dhe provat e proceduara ne shqyrtimin gjyqësore dhe detyrohet te vlerësoje çdo prove nje nga nje dhe ne lidhje me provat tjera dhe ne baze te vlerësimit te nxjerrët përfundim nëse fakti konkret provuar e që rastin konkret nuk ka arritur qe te vërtetohet qe i akuzuari e ka kryer veprën penale dhe se i akuzuari nuk ka mundur te shpallet fajtor vetëm me deklaratën e te dëmtuarit.

Andaj, gjykata e shkalles se pare ka ardhur ne përfundim se ne këtë çështje juridike-penale nuk ka prova te mjaftueshme se i akuzuari ta këtë kryer veprën penale, andaj, ne mungese te provave ka nxjerre aktgjykim lirues, e gjendjen faktike te vërtetuar nga ana e gjykata e shkalles se pare e vërteton edhe Gjykata e Apelit, me ç'rast konstaton se në rastin konkret kur të akuzuarin M.S. e ka liruar nga akuza drejtë e ka aplikuar edhe ligjin penal, andaj edhe pretendimet ankimore të Prokurorisë Themelore në Gjakovë në lidhje me shkeljen e ligjit penal në favor të të akuzuarit i refuzoi si të pabazuara.

Sa i përket ankeses se përfaqësuesit se palës se demtuar K.S., av.Agron Karatash, Gjykata e Apelit e ka hudhur si te palejuar bazuar ne nenin 381 par.3 të KPPRK-së

Nga arsyet e cekura më lartë, e në bazë të nenit 401 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
PA1.nr.782/23 më 12.12.2023

Procesmbajtës
Arben Arifi

Anëtarët e kolegjit
Abdullah Ahmeti

Kryetar i kolegjit,
Skender Çoçaj

Zyhdi Haziri
